




Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve

Rimbursimi i TVSH-së dhe Stoku

Tremujori i tretë Tetor-Dhjetor 2020

Tiranë, më 09 Shkurt 2021: Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, janë rimbursuar gjithsej 4,64 miliard lekë. Gjatë këtij tremujori, rreth 1,68 miliard lekë e vlerës së rimbursuar shkojnë për pagesën e kësteve për tatimpaguesit e mëdhenj në listën e tatimpaguesve me këste. Ndërsa numëri i kërkesave FIFO të miratuara dhe rimbursuara gjatë kësaj periudhe ka qënë në total 278 me vlerë rreth 2,96 miliard lekë.

Fig. 1 Rimbursimet tremujore të TVSH-së, T1 2018 – T4 2020 (milion lekë)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Gjatë tremujorit të katërt të 2020, pranë Dretorisë së Rimbursimit të TVSH-së janë regjistruar 393 kërkesa për rimbursim me vlerë rreth 6,22 miliard lekë, nga të cilat janë pranuar 285 kërkesa me vlerë rreth 3,81 miliard lekë dhe 108 kërkesa me vlerë rreth 2,41 miliard lekë nuk janë pranuar për mosplotësim të kriterëve ligjore.

: +355 4 22 76 840

e-tatime@tatime.gov.al

<https://www.tatime.gov.al/>

Rruga Gjin Bue Shpata, Tiranë, 1000





Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve

Në fund të tremujorit të katërt të 2020, stoku i rimbursimit të TVSH-së kapi vlerën rreth 9,80 miliard lekë nga 11,33 miliard që ishte në fund të tremujorit të tretë të vitit 2020. Kërkesat e miratuara për dy tatimpaguesit më të mëdhenj të cilat trajtohen me këste përbëjnë 88.5 % të totalit të stokut të rimbursimeve në fund të tremujorit të katërt të 2020. Ndërsa kërkesat FIFO u rimbursuan të gjitha duke mos krijuar stok në fund të këtij tremujori.

TAB.1 STOKU I RIMBURSIMIT TË TVSH-SË, 31 DHJETOR 2020

<i>(milion lekë)</i>	31.12.2019	31.03.2020	30.06.2020	30.09.2020	31.12.2020
Stoku gjithsej (1+2):	11,251	12,535	11,792	11,333	9,797
1. Tatimpaguesit me këste	11,251	12,535	11,792	11,333	9,797
Trans Adriatic Pipeline AG Albania	9,520	10,762	9,642	8,237	7,117
AYEN AS ENERGY	1,457	1,157	574	-	-
BANKERS PETROLEUM ALBANIA Shpk	-	-	768	1,817	1,557
Të tjerët tatimpagues me Keste	274	616	808	1,279	1,123
2. Tatimpaguesit FIFO	-	-	-	-	-

Metodologjia

: +355 4 22 76 840

e-tatime@tatime.gov.al

<https://www.tatime.gov.al/>

Rruga Gjin Bue Shpata, Tiranë, 1000





Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve

Qëllimi i publikimit tremujor të rimbursimit të TVSH-së dhe Stokut është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi rimbursimin e TVSH-së dhe nivelin e stokut.

Baza Ligjore

- Neni 77 të Ligjit 92/2014 datë 27.4.2017 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH" i ndryshuar,
- Neni 62, 63 dhe 64 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH", i ndryshuar,
- Neni 75/1 të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" I ndryshuar,
- Pika 75/1 të Udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar,
- VKM nr. 953, datë 29.12.2014, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, e ndryshuar,
- Udhëzimi Nr. 19, datë 3.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të vecantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar" i ndryshuar,
- "Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut"
- "Manualin për rimbursimin e TVSH-së".

Përkufizime

: +355 4 22 76 840



e-tatime@tatime.gov.al



<https://www.tatime.gov.al/>



Rruga Gjin Bue Shpata, Tiranë, 1000





Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve

Rimbursim i TVSH-së është vlera e TVSH-së që rimbursohet nga administrata tatimore, nëpërmjet degës së thesarit, në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

Stoku i rimbursimit të TVSH-së është vlera e TVSH-së e aprovuar për tu rimbursuar nga administrata tatimore, në pritje për tu kaluar në degën e thesarit. Stoku për një periudhë (mujore) llogaritet:

Stoku në fund të periudhës = Stoku në çelje + Kërkesat e miratuara gjatë periudhës – Rimbursimet e kyera.

Kërkesa për Rimbursim të TVSH-së janë kërkesa të adresuara pranë DRTVSH-së, nga tatimpaguesit që plotesojnë kriteret ligjore për rimbursim.

Kërkesa e Miratuar nënkupton shumën e TVSH-së së aprovuar për tu rimbursuar nga administrata tatimore, e cila reflektohet automatikisht në C@TS duke ulur tepricën kreditore të TVSH-së së tatimpaguesit.

Data e miratimit të kërkesës është data kur aprovohet (FirstApproval) kërkesa për tu rimbursuar në sistemin C@TS, nga administrata tatimore, e cila reflektohet automatikisht duke ulur tepricën kreditore të TVSH-së së tatimpaguesit.

Data e rimbursimit të kërkesës është data kur pagesa kalon nga Thesari në llogarinë e tatimpaguesit.

Tatimpagues me këste janë tatimpaguesit të cilët plotesojnë kriteret ligjore mbi bazën e të cilave administrata tatimore në dakortësi me tatimpaguesin ka lidhur një marrëveshje për pagesën me këste të TVSH-së së miratuar për tu rimbursuar.

: +355 4 22 76 840



e-tatime@tatime.gov.al



<https://www.tatime.gov.al/>



Rruga Gjin Bue Shpata, Tiranë, 1000





Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve

Në këtë faqe do të gjeni të pasqyruar informacionin mbi TVSH e rimbursuar për tremujorin e katërt të vitit 2020 dhe nivelin e Stokut në datë 31.12.2020.

Ky publikim bëhet në kuadër të rritjes së transparencies dhe informimin e të gjitha palëve që kanë interesë me situatën faktike të rimbursimit të TVSH-së dhe stokut të rimbursimeve.

: +355 4 22 76 840



e-tatime@tatime.gov.al



<https://www.tatime.gov.al/>



Rruga Gjin Bue Shpata, Tiranë, 1000

